**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE**

**"SIDEC Alb Real Estate" sh.p.k**

**Tiranë më datë 09 / 08 /2022**

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare **"SIDEC Alb Real Estate" sh.p.k** (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statuti të miratuara prej saj.

**NENI 2**

**Emri i Shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin **"SIDEC Alb Real Estate" sh.p.k**

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

- Veprimtaria ekonomike në fushën real estate(pasurive të paluajshme), që ka të bëjë me negocime, ndërmjetësime, përfaqësime të të tretëve në fushën real estatei në tregun e brendshëm ashtu dhe në atë ndërkombëtar;
- Shitje, blerje, dhënie me qira të të gjitha llojeve të pasurive të paluajtshme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe çdo transaksion tjetër në funksion të përmbushjes së objektit të veprimtarisë në fushën real estate, midis personave fizikë,personave jurdikë privatë dhe publikë si dhe nga shteti si dhe çdo veprim tjetër i ligjshëm që ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme;
- Shitje- Blerje ë ndërtimeve të ndryshme, dizajnimi, ndërtimi dhe shitja e infrastrukturave imobiliare, real estate;
- Veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit të strukturave turistikepritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkt apo indirekt të lidhura me to, si në tregun e brendshëm ashtud he në atë të jashtëm ndërkombëtar;
- Hapjen dhe menaxhimin e bareve dhe restoranteve;
- Kryerja e të gjitha punimeve të ndryshme në fushën e ndërtimit, përfshirë koalidimin, restaturimin të ndërtesave të ndryshme.
- Hapja e dyqaneve të ndryshme.
- Krijimi i retaileve për marka të ndryshme pa u kufizuar.

Shoqëria mund të ushtrojë çdo lloj aktiviteti tregtar që legjislacioni i Republikës së Shqipërisë nuk e ndalon.

**NENI 4**

**Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga e Barrikadave; Qendra Turdiu; K2; N17, Tiranë, Shqipëri.**

**NENI 5**

**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakut themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën **100.000 (njëqind mijë) lekë**.

Kapitali ndahet në 1 (një) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortaku i shoqërisë vijon si më poshtë:

1. ***Shoqëria "SIDEC AlbEnergy" sh.p.k***, shoqëri e të drejtës shqiptare, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 13.12.2019 dhe pajisur me NUIS L92413017D, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100 % të vlerës së kapitalit themeltar, të barabartë me 1 (një) kuotë me vlerë **100.000 (njëqind mijë) Lekë.**

Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortaku themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është nënshkruar nga Ortaku Themelues.

**NENI 6**

**Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

**NENI 7**

**Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – Organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administrator – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rigjedhjeje.

Administratori i parë i shoqërisë është **z. Andrea Di DIO**, lindur më 28/01/1976 në Gela, Itali, shtetas Italian, identifikuar nëpërmjet ID së lëshuar nga autoritetet italiane me nr. CA27279KU, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administatori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

**NENI 8**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit vit finanaciar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

**NENI 9**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

**NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi i shoqrisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përatës dhe statutit.

**NENI 11**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

**NENI 12**

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rretit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 13**

**Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

**ORTAKU**

"SIDEC Alb Real Estate" sh.p.k

SIDEC ALB REAL ESTATE Sh.p.k.
Rruga e Barrikadave - Qendra Turdiu
K2 - N 17 - Tirane, Shqiperi - AL